



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:149309

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05527001

KPPP.nr.1030/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.P. “Inox”, me NUI:80683880, me seli në Gjakovë, rruga “Tirana” p.n., kundër debitorit “AS Bytyqi Construction” SH.P.K., me NUI:811253666, me seli në Fushë Kosovë, rruga “Nëna Terezë” p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.230/23 të datës 18.04.2023, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 29.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “AS Bytyqi Construction” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.230/23 të datës 18.04.2023, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.230/23 i datës 18.04.2023, i Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.230/23 të datës 18.04.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.144/21 të datës 10.03.2021; Faturës Nr.422/22 të datës 04.08.2022; dhe Faturës Nr.710/22 të datës 01.12.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që

kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 10,291.68 €, me kamat ligjore 8% duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën përfundimtare, ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se kreditori me numër biznesi 80683880, me seli në Gjakovë është i shuar, ndërsa në faturë po ashtu ka numrin e biznesit të shuar nr.810231150, pra kreditori i cili ka iniciuar këtë procedurë përmbarimore është i shuar, ndërsa personi fizik i cili ka nënshkruar ka bërë veprim të palejuar, mashtrues. Tutje ka shtuar se pronari i kreditorit ka regjistruar biznes te ri me veprimtari të njëjtë, dhe me debitorin janë marrë vesh të vazhdojnë bashkëpunimin siç kanë bashkëpunuar më herët, sa i përket faturave ka deklaruar se për pjesën e faturave për të cilat janë barazuar i ka përmbushur detyrimet ndërsa faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk janë barazuar me kreditorin. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka deklaruar se pretendimet e debitorit se biznesi është i shuar janë të vërteta, pasi që kreditori e ka regjistruar biznesin me emrin e ri "Inox 90" L.L.C., me NUI:812004274, me seli në Gjakovë, rruga "Tirana", ku përfaqësues i këtij biznesi si dhe i biznesit të shuar është kreditori M.D., përkatësisht siç mund të vërtetohet edhe nga Regjistri në ARBK, kreditori ka bërë kalimin e biznesit nga biznes individual në SHPK. Tutje ka shtuar se debitori nuk e kundërshton borxhin, si dhe deklaron se ende bashkëpunon me kreditorin. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnim me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbnim për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.144/21 të datës 10.03.2021, Faturën Nr.422/22 të datës 04.08.2022 dhe Faturën Nr.710/22 të datës 01.12.2022, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.144/21 e datës 10.03.2021, Fatura Nr.422/22 e datës 04.08.2022 dhe Fatura Nr.710/22 e datës 01.12.2022, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbnimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit.

Gjykata shqyrtoi pretendimin e debitorit sa i përket legjitimitetit të kreditorit në këtë procedurë përmbnimore dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar, për faktin se sipas Vërtetimit tatimor të bashkangjitur rezulton se kreditori N.T.P. “INOX”, me NUI:80683880, dhe NRB:810231150, ka bërë ndryshimin e formës së biznesit nga Biznes Individual (B.I) në Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K), duke regjistruar biznes me emër të ri “INOX 90” L.L.C., me NUI:812004274, andaj në procedurën përmbnimore lidhur me vlerësimin e legjitimitetit të

palëve, gjykata bazohet në përmbajtjen e dokumentit në bazë të cilit iniciohet dhe zhvillohet procedura përbarimore, pra përbarimi mund të caktohet me kërkesën e personit i cili sipas dokumentit është i autorizuar ta kërkoj, ndaj personit që sipas dokumentit detyrohet për përmbushje, sepse në këtë rast propozimi për përbarim është paraqitur nga kreditori N.T.P. “INOX”, me NUI:80683880, i cili figuron si kreditor edhe në dokumentet e besueshme – faturat me NRB:810231150, të cilat janë objekt shqyrtimi në këtë procedurë përbarimore.

Gjykata po ashtu i shqyrtoi pretendimet e debitorit sipas të cilave kreditori N.T.P. “INOX”, me NUI:80683880, është biznes i shuar, andaj si i tillë një subjekt i shuar nuk mund të jetë palë në procedurë, nuk mund të paraqes propozim për përbarim dhe nuk mund të caktohet përbarimi, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore për faktin se nga certifikata e biznesit e dorëzuar si provë nga vet i padituri rezulton se kreditori N.T.P. “INOX”, në Agjencinë e regjistrimit të bizneseve të Kosovës ka qenë i regjistruar si biznes individual.

Sipas nenit 48 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, par. 1, përcaktohet se: *“...Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një Biznes Individual. Kjo përgjegjësi është e pa-kufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij Personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona ose asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake...”*, ndërsa me par. 3 përcaktohet se: *“Biznesi Individual nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhë kontratë, të ketë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë i paditur, në emrin e Biznesit Individual apo të pronarit”*.

Sipas dispozitave të lartcekura rezulton se biznesi individual është person fizik i cili nuk ka subjektivitet të ndarë nga pronari i tij dhe si i tillë pronari i një biznesi individual ka përgjegjësi të pakufizuara personale për të gjitha detyrimet e biznesit individual dhe shuarja e biznesit individual nuk përbën fakt relevant për përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin e të drejtave të tij.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në

kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1030/23, datë 29.03.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.